



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I LARTE GJYQESOR

**KOMISIONI I PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE
DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJË MAGJISTRATI (GJYQATAR) PËR
TË PËRFITUAR KREDI PËR BANIM, SI DHE MIRATIMIN E LISTËS SË
MAGJISTRATËVE (GJYQATAR) PËRFITUES NGA SKEMA E SUBVENCIONIMIT TË
INTERESAVE TË KREDISË**

Nr. 6354/1Prot.

Tiranë, më 14.12.2023

VENDIM

Nr. 1, datë 11.12.2023

PËR

**PLOTËSIMIN E KUSHTEVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË
PLOTËSOJË MAGJISTRATI (GJYQATAR) PËR TË PËRFITUAR KREDI PËR BANIM,
SI DHE MIRATIMIN E LISTËS SË MAGJISTRATËVE (GJYQATARË) PËRFITUES
NGA SKEMA E SUBVECONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË**

I. HYRJE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 147, të Kushtetutës ka përgjegjësi jo vetëm për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, kjo e fundit tregues i qartë i përgjegjësive në fushën e statusit të gjyqtarëve i cili në përmbajtje ka një sistem garancish, përfshirë këtu edhe të drejtën e kreditimit për qëllime banimi, interesat e të cilës financohen nga shteti. Një sistem të tillë garancish gjyqtarët e gëzojnë edhe në akte ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “*Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit*” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension dhe çdo aspekt tjetër duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme. Në fakt statusi i magistratëve i përcaktuar në nenin 1, të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, përfaqëson një sistem garancish në funksion të përgjegjshmërisë dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Paketa e të

drejtave, detyrimeve dhe garancitë që lidhen me gëzimin e statusit të magistratëve pavarësisht se në pamje të parë të krijojnë përshtypjen e një privilegji të veçantë për magistratët/gjyqtarët, nëpërmjet realizimit të pavarësisë së tyre kanë si pikënisje ofrimin e garancive për qytetarët e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të tyre.

Kuvendi i Shqipërisë me amendimet kushtetuese dhe paketës së legjislacionit në fushën e drejtësisë ka synuar të rivendosja e ekuilibrave kushtetues për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve dhe mbi të gjitha në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Nga ana tjetër në paketën e reformës në drejtësi janë pasqyruar edhe dispozita ligjore të cilat synojnë të përmirësojnë dhe të garantojnë jo vetëm statusin e magistratit, por siç edhe theksuam edhe më lart pavarësinë e tyre. Këtij qëllimi i shërben neni 17, i ligjit nr.96/2016, *“Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i cili përcakton Këshillin e Lartë Gjyqësor si autoriteti që mundëson miratimin e kredisë për magistratët, të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në sistemin gjyqësor shqiptar. Natyrisht në përputhje me këtë dispozitë, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr kushtet, kriteret dhe kufizimet të financimit nga buxheti i shtetit të magistratëve të cilët kërkojnë trajtimin me kredi hipotekare për qëllime banimi.

Më konkretisht neni 17, i ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, përcakton se : *“Magjistrati ka të drejtë që një herë gjatë ushtrimit të funksionit të tij, pasi të ketë ushtruar jo më pak se tre vjet të detyrës, të përfitojë kredi për shtëpinë të financuar nga shteti, në shumën e vlerës mesatare të një apartamenti prej 50 m² në zonën e qendrës së qytetit ku magjistrati ushtron detyrën; 2. Për çdo anëtar të familjes, sipas parashikimeve të pikës 5, të këtij neni, i cili jeton në të njëjtën banesë me magjistratin, masa referuese e sipërfaqes së banesës shtohet me 10 m² për person. Në rast se në një familje, dy persona kanë të drejtë të përfitojnë kredi për shtëpi të subvencionuar nga shteti, do të përfitohet vetëm nga një prej tyre. 3. Banesa e blerë nëpërmjet kredisë lihet kolateral në bankë për sigurimin e kredisë. 4. Magjistrati ka të drejtën të gëzojë pronën për nevojat e tij, si dhe të familjes së tij për nevojat për strehim. Magjistrati ka të drejtë të shesë pronën gjatë kohës së amortizimit të kredisë dhe të blejë një banesë tjetër. Në rastet kur shuma e përfituar nga shitja është me e madhe se rritja e vlerës së tregut të pronës, atëherë diferenca do t’i kthehet shtetit. Magjistrati nuk ka të drejtë të japë me qira banesën e përfituar me kredi...omissis..7. Këshilli i Ministrave miraton legjislacionin mbështetës për marrëveshjet me bankat për skemën e huamarrjes, në të cilën do të parashikohen kriteret dhe kushtet për kontratën e kredisë, si dhe detyrimet e shtetit lidhur me interesat e huamarrjes. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të detajuara për procedurën e dhënies së kredisë për shtëpi, si dhe kriteret dhe kushtet që magjistrati përmbush në përputhje me parashikimet e këtij neni.”*

Dispozita e mësipërme synon të vendosë rregullat e përgjithshme që zbatohen për përfitimin nga gjyqtari të kredisë për qëllime banimi, interesat e të cilës financohen nga shteti në kuadër të kontributit për ruajtjen e pavarësisë së tij në ushtrimin e funksionit. Kjo paketë financiare/kredi për shtëpi është një nga instrumentet e parashikuar nga neni 11, pika 3, shkronja ç, e ligjit nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve ne Republikën e Shqipërisë”, e cila ka si qëllim të përmirësojnë rrënjësisht trajtimin financiar dhe masat mbështetëse për gjyqtarin, i cili me përcaktimin e kriterëve, *in expressis verbis*, të mirë përcaktuara, për përfitimin e saj eviton krijimin e situatave të varësisë së papërshtatshme të funksionit të gjyqtarit nga ekzekutivi.

Parimi i ruajtjes së dinjitetit të detyrës së gjyqtarit dhe garantimi i pavarësinë dhe mbrojtjes së tij nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre i shërben edhe parashikimi i pikës 1, të nenit 11 dhe nenit 17, të ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve ne Republikën e Shqipërisë” me anë të së cilit mbrohen paga dhe përfitimet financiare të gjyqtarit. Në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve ne Republikën e Shqipërisë” me eksperience minimale tre vjeçare në ushtrimin e funksionit ka të drejtë të kërkojë të përfitojë kredinë e financuar nga buxheti i shtetit për qëllime banimi. Në thelb të kërkimit është përmbushja e nevojave sociale për strehimin e familjes së tij, kur ai/ajo ose familjarët e tyre nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të përmbushur vetë këto nevoja.

Më tej ligji ka përcaktuar edhe vlerën maksimale të kredisë të përfituar nga gjyqtari, së cilës shteti i subvencionon interesat dhe që është e barabartë dhe e krahasueshme me vlerën mesatare të një apartamenti prej 50 m² në zonën e qendrës së qytetit ku gjyqtari ushtron funksionin. Masa referuese e sipërfaqes së shfrytëzueshme të banesës, shtohet me 10 m² për çdo anëtar të familjes që jeton në të njëjtën banesë me gjyqtarin. Vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, në rastin, *de qua*, llogaritet dhe i referohet Udhëzimit të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Metodologjisë për llogaritjen e çmimit mesatar të shitjes së banesave në treg” nr. 1, datë 17.03.2023. Në kuptim të nenit 53, të Kushtetutës, nenit 1, 3 dhe 5, të Kodit të Familjes si dhe përkufizimit të dhënë nga Fjalori i Gjuhës Shqipe, me familje kuptohet një njësi e vogël e organizimit të jetës shoqërore që përbëhet nga prindërit e fëmijët ose edhe nga njerëz të tjerë të afërm, të cilët jetojnë e banojnë bashkë. Sipas këtij përkufizimi, neni 14, i ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar përcakton që shtetasit kanë të drejtë të kenë një ose më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar.

Në kryerjen e procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të cituara edhe më lart Këshilli i Lartë Gjyqësor u mbështet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 15.01.2020, “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e të cilës financohen nga shteti”, kjo për shkak se nëpërmjet një dispozite deleguese, neni 17, i ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve ne Republikën e Shqipërisë” ka autorizuar Këshillin e Ministrave të miratojë legjislacionin mbështetës për marrëveshjet me bankat për skemën e

huamarrjes si dhe rregullat e detajuara, kushtet dhe procedurat që duhet të përmbushen nga gjyqtarët për përfitimin e kredisë për shtëpi.

Në funksion të marrëveshjes dypalëshe nr. 8481/3, datë 01.8.2022 dhe nr. 1680/4, datë 11.8.2022, “Për kreditimin në kuadër të programit të subvencionimit të interesave të kredisë për magjistratin”, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe OTP bank, Marrëveshjes dypalëshe nr.174, datë 15.5.2023 dhe nr. 2905, datë 16.5.2023, “Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër mes Bankës OTP Albania Sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Përfitimin e Kredisë për Qëllime Banimi nga Magjistratët”, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe OTP bank, Këshilli ka vendosur me vendimin nr. 302, datë 05.06.2023, ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë. Në kuptim të kësaj marrëveshje gjyqtari do të ketë detyrimin për të paguar principalin (kryegjënë) dhe shteti nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësorë do të ketë detyrimin për të paguar interesat.

Komisioni i Përkohshëm në mbledhjen e datës 16.06.2023, konstatoi se është përmbushur detyrimi ligjor për njoftimin e magjistratëve (gjyqtarë) sipas disa shkresave datë 28.05.2021, drejtuar gjykatave të të gjitha niveleve. Konkretisht, nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rezultoi se kërkesat me shkrim të 8 (tetë) magjistratëve (gjyqtarë), për shprehje interesi për trajtim me kredi për shtëpi të financuar nga shteti, i takojnë periudhës nga 09.06.2021 deri në 20.04.2023. Në këto kushte, Komisioni vendosi që të njoftohen përsëri magjistratët (gjyqtarë) që kanë shprehur interes për trajtim me kredi për shtëpi, të financuar nga shteti, për përditësimin e dokumentacionit referuar pikës 8, të VKM-së nr. 22, datë 15.01.2020.

Aktualisht, bazuar në të dhënat e administruara nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën, kanë riparqitur kërkesë me shkrim 6 (gjashtë) magjistratë (gjyqtarë) për shprehje interesi për trajtim me kredi për shtëpi, të financuar nga shteti. Konkretisht, si më poshtë:

- a) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me nr.3872 prot., datë 11.07.2023);
- b) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (me nr. 4805 prot., datë 18.09.2023);
- c) {...} – gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar (me nr. 4688 prot., datë 12.09.2023);
- d) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me nr.3715 prot., datë 29.06.2023);
- e) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me nr. 3956 prot., datë 13.07.2023);
- f) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (me nr. 4252 prot., datë 21.07.2023).

Gjithashtu nga ana e Komisionit të Përkohshëm me qëllim verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjqqtar) për të përfituar kredi për banim, u vendos që të kërkohet vërtetim nga bankat e nivelit të dytë mbi depozita/ llogari rrjedhëse/ bono thesari, vërtetim negativ nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve, vënia në dispozicion e deklaratave të pasurisë dhe interesave private “Për Subjekte në Funkcion 2021” dhe “Periodike Vjetore 2022” nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave si dhe të kërkohet informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor lidhur me kontrata shit-blerje automjeti për periudhën Janar- Qershor 2023, për magjistratët (gjqqtarë) që kanë shprehur interes pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. PROCEDURA E NDJEKUR NGA KOMISIONI

Në zbatim të VKM-së nr. 22, datë 15.01.2020 “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti”, për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për magjistratët, të cilët kanë shprehur interesin për trajtim me kredi për shtëpi të financuar nga shteti, Komisioni ndërmori veprimet e mëposhtme:

► Në datën 03.07.2023 nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ në përgjigje të shkresës nr. 3583 prot., datë 16.06.2023, të KLGJ-së, “Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të deklaratave të pasurisë”, janë dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor kopje të deklaratave të pasurisë dhe interesave private “Për subjekte në funksion 2021” dhe “Periodike vjetore 2022” të deklaruara nga magjistratët, të cilët kanë shprehur interesin për trajtim me kredi për shtëpi të financuar nga shteti.

► Në datën 29.06.2023 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor² në përgjigje të shkresës nr. 3642 prot., datë 23.06.2023, të KLGJ-së, “Kërkesë për informacion”, është përcjellë informacioni në Këshillin e Lartë Gjyqësor se magjistratët, të cilët kanë shprehur interesin për trajtim me kredi për shtëpi të financuar nga shteti nuk kanë mjete të rregjistruara pranë këtij institucioni.

► Në datën 26.09.2023 u kërkua nga 12 institucione bankare³ që të konfirmonin nëse magjistratët dhe familjarët e tyre, disponojnë llogari, depozita bankare (shumën nëse ka të tilla), si edhe nëse nga ana e tyre është vepruar si agjentë/kujdestar për blerjen, ruajtjen e bonove të thesarit.

¹ Shkresa nr. 2886/1 prot., datë 30.06.2023 e ILDKPKI-së, “Kthim përgjigje”

² Shkresa nr. 12528/1 prot., datë 29.06.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, “Kthim përgjigje”

³ Shkresa nr. 4960 prot., datë 26.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Kërkesë për informacion”

1. Sipas materialit të dërguar nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 4105/1 prot., datë 28.09.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – nuk rezulton që deri në datën 28.09.2023, këta shtetas të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar;
- b) Kurse me shkresën me nr. 4732/1 prot., datë 06.11.2023, të dërguar nga Banka e Shqipërisë⁴, është përcjellë informacioni se {...} dhe {...} (e bija) nuk figurojnë të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – nuk rezulton që deri në datën 28.09.2023, këta shtetas të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – nuk rezulton që deri në datën 28.09.2023, këta shtetas të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – nuk rezulton që deri në datën 28.09.2023, këta shtetas të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar;
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – nuk rezulton që deri në datën 28.09.2023, këta shtetas të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar.

2. Sipas materialit të dërguar nga Raiffeisen Bank me shkresën nr. 29143/1 prot., datë 02.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar kopje të noterizuar të një e-maili nga Raiffeisen Bank të datës 27.06.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk janë kliente të kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk janë kliente të kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë kliente të kësaj banke;
- e) {...} – rezulton që nuk është kliente e kësaj banke, kurse {...} (bashkëjetuesi) është klient i kësaj banke;
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.

3. Sipas materialit të dërguar nga Banka Kombëtare Tregtare Sh.A me shkresën nr. 6362/2 prot., datë 30.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar kopje të noterizuar të një e-maili nga Banka Kombëtare Tregtare Sh. A të datës 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk disponojnë asnjë llogari apo depozitë pranë kësaj banke;

⁴ Në përgjigje të shkresës me nr. 5710 prot., datë 01.11.2023, “Kërkesë për informacion”

- c) {...} – rezulton që nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke, kurse {...} (bashkëshortja) ka patur llogari, por është mbyllur në datën 26.10.2020;
- d) {...} – rezulton që ka llogari page, kurse {...} (bashkëshorti) rezulton që nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke;
- e) {...} – rezulton që ka llogari pranë kësaj banke të hapur në datë 27.12.2007, kurse {...} (bashkëjetuesi) rezulton që nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke;
- f) {...} – rezulton që ka llogari pranë kësaj banke të hapur në datë 27.07.2010, kurse {...} (bashkëshorti) rezulton që nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke.

4. Lidhur me Bankën Intesa Sanpaolo Sh. A. është administruar informacioni si më poshtë:

- a) {...} – ka depozituar shkresën nga Banka Intesa Sanpaolo Sh. A të datës 05.12.2023 nga e cila rezulton që ajo nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke, kurse për {...} (bashkëshorti) rezulton që ka pasur një llogari, e cila është mbyllur;
- b) {...} – ka depozituar shkresën nga Banka Intesa Sanpaolo Sh. A të datës 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk janë klientë të kësaj banke dhe si rrjedhojë nuk kanë asnjë marrëdhënie me bankën;
- c) {...} – ka depozituar shkresën nga Banka Intesa Sanpaolo Sh. A të datës 23.11.2023, nga e cila rezulton që ai vetë dhe {...} (bashkëshortja) nuk janë kliente të kësaj banke dhe si rrjedhojë nuk kanë asnjë marrëdhënie me bankën.
- d) {...} – ka depozituar statement të bankës të datës 05.12.2023 dhe rezulton që është kliente e kësaj banke;
- e) {...} – ka depozituar shkresën nga Banka Intesa Sanpaolo Sh. A të datës 07.12.2023, nga e cila rezulton nuk është kliente e kësaj banke dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë marrëdhënie me bankën;
- f) {...} – ka depozituar shkresën nga Banka Intesa Sanpaolo Sh. A me nr. 23/33768 prot., datë 07.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (bashkëshorti) nuk janë kliente të kësaj banke.

5. Sipas materialit të dërguar nga Banka Tirana Sh. A me shkresën nr. 21686 prot., datë 05.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} – rezulton që ka patur llogari rrjedhëse pranë kësaj banke për periudhën 2005-2016, kurse {...} (bashkëshorti) rezulton që nuk ka marrëdhënie pranë kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka Tirana Sh. A me nr.14882 prot., datë 11.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk janë kliente të kësaj banke dhe për rrjedhojë nuk disponojnë llogari apo depozita bankare. Gjithashtu, Banka Tirana Sh. A nuk ka vepruar asnjëherë si agjent/kujdestar për blerjen/ruajtjen e bonove të thesarit në emrin e tyre;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk ka marrëdhënie pranë kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk ka marrëdhënie pranë kësaj banke;

- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që nuk ka marrëdhënie pranë kësaj banke;
- f) {...} nuk ka llogari personale pranë kësaj banke, por ka patur të drejtë veprimi në llogarinë e {...} (bashkëshorti), i cili ka patur llogari pranë kësaj banke për periudhën 2006-2014, si dhe kanë qenë kredimarrës në vitin 2008.

6. Sipas materialit të dërguar nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh. A me shkresën nr.271081023/46432/1 prot., rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh. A të datës 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk disponojnë llogari bankare pranë kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.

7. Sipas materialit të dërguar nga Banka Procredit Sh. A me shkresën nr. 63424/1 prot., datë 02.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} – rezulton që nuk ka llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke, kurse {...} (bashkëshorti) ka pasur 4 (katër) llogari bankare, të cilat aktualisht rezultojnë me status të mbyllur;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka Procredit Sh. A me nr.38900/1 prot., datë 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë ka pasur 1 (një) llogari, e cila është mbyllur në datën 31.07.2017, ndërsa për {...} (e bija) rezulton që nuk ka llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke;
- c) {...} – rezulton që ka pasur 2 (dy) llogari bankare, të cilat aktualisht rezultojnë me status të mbyllur, kurse {...} (bashkëshortja) rezulton që nuk ka llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk kanë llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke;
- e) {...} – rezulton që nuk ka llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke, kurse {...} (bashkëjetuesi) ka 3 (tre) llogari bankare, nga të cilat aktualisht 1 (një) rezulton me status aktiv, 1 (një) me statusin përgatitur për tu mbyllur dhe 1 (një) llogari rezulton me status të mbyllur.
- f) {...} – rezulton që nuk ka llogari dhe produkte bankare pranë kësaj banke, kurse {...} (bashkëshorti) ka pasur llogari bankare, e cila rezulton me status të mbyllur.

8. Sipas materialit të dërguar nga Banka e Parë e Investimeve Sh. A me shkresën nr.44092 prot., datë 27.09.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse me shkresën me nr. ON-A-54897 prot., datë 03.11.2023, të dërguar nga Banka e Parë e Investimeve Sh. A⁵, – rezulton që gjyqtare {...} dhe {...} (e bija) nuk janë kliente të kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.

9. Sipas materialit të dërguar nga Banka Amerikane e Investimeve Sh. A me shkresën nr.06678 prot., datë 28.09.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk disponojnë llogari apo depozita pranë kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka Amerikane e Investimeve Sh. A me nr. 2B-003828 prot., datë 29.06.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk disponojnë llogari pranë kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk disponojnë llogari apo depozita pranë kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk disponojnë llogari apo depozita pranë kësaj banke;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që nuk disponojnë llogari apo depozita pranë kësaj banke;
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk disponojnë llogari apo depozita pranë kësaj banke.

10. Sipas materialit të dërguar nga Credins Bank Sh. A me shkresën nr. 38884/1 prot., datë 18.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Credins Bank me nr. 26105 P/1 prot., datë 12.07.2023 rezulton që është kliente e bankës;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që janë klientë të kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që janë klientë të kësaj banke;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që janë klientë të kësaj banke.
- f) {...} – rezulton që nuk ka llogari rrjedhëse, depozitë me/pa afat në emër personal dhe nuk ka qenë në marrëdhënie blerje apo shitje bono thesari, obligacione, apo në marrëdhënie

⁵ Në përgjigje të shkresës me nr. 5710 prot., datë 01.11.2023, “Kërkesë për informacion”

huaje/kredie me Credins Bank, kurse {...} (bashkëshorti) ka qenë klient në Credins Bank, por nuk zotëron llogari rrjedhëse individuale aktualisht.

11. Sipas materialit të dërguar nga Banka Union Sh. A me shkresën nr. 7055/1 prot., datë 05.10.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka Union Sh. A me nr. 5361 prot., datë 10.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk janë klientë të kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.
- f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke.

12. Sipas materialit të dërguar nga Banka OTP Albania Sh. A me shkresën nr. 23/16388/tbo prot., datë 29.09.2023, rezultoi si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- b) Kurse gjyqtare {...} ka depozituar shkresën nga Banka OTP Albania Sh. A me nr.61 prot., datë 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo vetë dhe {...} (e bija) nuk janë klientë të kësaj banke;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – rezulton që nuk janë klientë të kësaj banke;
- d) {...} – rezulton që ka pasur llogari bankare, e cila është mbyllur në datë 13.06.2018, kurse {...} (bashkëshorti) rezulton që nuk është klient i kësaj banke;
- e) {...} – rezulton që ka pasur 7 (shtatë) llogari, nga të cilat 5 (pesë) janë mbyllur respektivisht në datat 14.12.2017, 31.10.2014, 20.02.2015, 10.07.2015 dhe 09.02.2016, kurse {...} (bashkëjetuesi) nuk është klient i kësaj banke.
- f) {...} – rezulton që nuk është kliente e kësaj banke, kurse {...} (bashkëshorti) ka pasur 4 (katër) llogari, nga të cilat 2 (dy) janë mbyllur respektivisht në datat 27.05.2019 dhe 29.12.2021.

► Me shkresën nr. 4959 prot., datë 26.09.2023, “*Kërkesë për informacion*” iu është kërkuar 3 institucioneve që të konfirmojnë nëse magjistratët (të cilët kanë shprehur interesin për trajtim me kredi për shtëpi të financuar nga shteti) dhe familjarët e tyre disponojnë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe/ose tituj pronësie përfshirë edhe të drejtat reale pasurore.

1. Sipas materialit të dërguar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me shkresën me nr.18993/1 prot., datë 29.09.2023, është përcjellë informacioni si më poshtë:

- a) {...} – nuk figuron të jetë e pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrin tregtar, kurse {...} (bashkëshorti) figuron i regjistruar në QKB subjekti “{...}” si person fizik me status aktiv;
- b) Kurse me shkresën me nr. 21643/1 prot., datë 09.11.2023, të dërguar nga Qendra Kombëtare e Biznesit⁶, është përcjellë informacioni se {...} dhe {...} (e bija) nuk figurojnë të jenë të regjistruar si person fizik apo zotërues të kuotave/aksioneve në shoqëri të regjistruara në regjistër;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – nuk figurojnë të jenë të pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrin tregtar;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – nuk figurojnë të jenë të pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrin tregtar;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – nuk figurojnë të jenë të pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrin tregtar;
- f) {...} – dhe {...} (bashkëshorti) nuk figurojnë të jenë të pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrin tregtar.

2. Sipas materialit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare me shkresat me nr. 9074/1 prot., datë 11.10.2023 dhe nr. 2253/1 prot., datë 14.11.2023 është përcjellë informacioni se për magjistratët dhe familjarët e tyre nuk rezultojnë të regjistruara mjete lundruese.

3. Lidhur me të dhënat nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës është administruar dokumentacioni si më poshtë:

- a) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – kanë depozituar vërtetimet e datës 20.06.2023, ku rezulton që nuk kanë pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;
- b) {...} – ka depozituar vërtetimin e datës 10.07.2023, ku rezulton që nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;
- c) {...} dhe {...} (bashkëshortja) – kanë depozituar vërtetimin me nr. 6027 prot., datë 08.09.2023, ku rezulton që nuk kanë pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;
- d) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – kanë depozituar vërtetime negative të datës 14.04.2023, ku rezulton që nuk kanë pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë;
- e) {...} dhe {...} (bashkëjetuesi) – kanë depozituar vërtetimet e datës 29.06.2023, ku rezulton që nuk kanë pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;

⁶ Në përgjigje të shkresës me nr. 5710/1 prot., datë 01.11.2023, “Kërkesë për informacion”

f) {...} dhe {...} (bashkëshorti) – kanë depozituar vërtetimet e datës 06.10.2021, ku rezulton që nuk kanë pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

► Lidhur me të dhënat nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve⁷ është administruar dokumentacioni si më poshtë:

- a) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.110/1 prot., datë 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere apo nga shitblerja që nga periudha 1996 (që është krijuar QRA sh.a) dhe deri në datë 06.07.2023;
- b) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.112/1 prot., datë 06.09.2023, nga e cila rezulton që ajo nuk ka përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere apo nga shitblerja që nga periudha 1996 (që është krijuar QRA sh.a) dhe deri në datë 06.09.2023;
- c) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.158 prot., datë 07.09.2023, nga e cila rezulton që ai dhe {...} (bashkëshortja) nuk rezultojnë aksioner pranë Qendrës së Rregjistrimit të Aksioneve, në shoqëritë që janë të regjistruara në arkivën e këtij institucioni;
- d) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.111/1 prot., datë 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo nuk ka përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere apo nga shitblerja që nga periudha 1996 (që është krijuar QRA sh.a) dhe deri në datë 06.07.2023;
- e) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.113/1 prot., datë 06.07.2023, nga e cila rezulton që ajo nuk ka përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere apo nga shitblerja që nga periudha 1996 (që është krijuar QRA sh.a) dhe deri në datë 06.07.2023;
- f) {...} – ka depozituar shkresën nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve me nr.236 prot., datë 06.12.2023, nga e cila rezulton që ajo nuk ka përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere apo nga shitblerja që nga periudha 1996 (që është krijuar QRA sh.a) dhe deri në datë 06.12.2023.

III. KONKLUZIONE

► Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 15.01.2020 “*Për miratimin e procedurës së detajuar, të kritereve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti*”, pika 6, janë përcaktuar kushtet që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim.

⁷ Shkresa me nr. 4964 prot., datë 26.09.2023, “*Kërkesë për informacion*”

Lidhur me plotësimin e këtyre kushteve, Komisioni i Përkohshëm konkludoi lidhur me të 6 (gjashtë) magjistratët (gjqqtarë) që kanë shprehur interes për trajtim me kredi për shtëpi, të financuar nga shteti, ku rezultoi se:

- a) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 05.10.2007 dhe në vazhdim;
 - nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;
 - nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;
 - magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;
 - magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.
- b) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 25.06.2010 dhe në vazhdim;
 - nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;
 - nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;
 - magjistratja dhe {...} (e bija) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;
 - magjistratja dhe {...} (e bija) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.
- c) {...} – gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 10.10.2012 dhe në vazhdim;
 - nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;
 - nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;

- *magjistrati dhe {...} (bashkëshortja) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;*
 - *magjistrati dhe {...} (bashkëshortja) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.*
- d) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- *ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 27.09.2010 dhe në vazhdim;*
 - *nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;*
 - *nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;*
 - *magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;*
 - *magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.*
- e) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- *ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 10.10.2012 dhe në vazhdim;*
 - *nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;*
 - *nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;*
 - *magjistratja dhe {...} (bashkëjetuesi) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;*
 - *magjistratja dhe {...} (bashkëjetuesi) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.*
- f) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- *ka filluar të ushtrojë detyrën në funksionin e gjyqtarit nga data 04.10.2006 dhe në vazhdim;*
 - *nuk ka përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të saj;*
 - *nuk ka përfituar kredi për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së saj, i cili ka të drejtë përfitimi të kësaj kredie;*

- *magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pronësi të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri e paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;*
- *magjistratja dhe {...} (bashkëshorti) nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë me shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti.*

► Bazuar sa më sipër, Komisioni konkludon se është rasti për të vendosur që të 6 (gjashtë) magjistratët (gjyqtarë), të cilët kanë paraqitur kërkesën pranë këshillit të Lartë Gjyqësor, për të përfituar kredi për shtëpi të financuar nga shteti, i plotësojnë kushtet dhe dokumentacioni i depozituar është i plotë dhe konform kërkesave ligjore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në pikën 14, të nenit 62 dhe pikën 1, të nenit 70, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Përkohshëm;

V E N D O S I:

1. Konstatimin e plotësimin të kushteve/kritereve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim të financuar nga shteti, sipas listës së pikës 2, të këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtar) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë si më poshtë:
 - a) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - b) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - c) {...} – gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar;
 - d) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
 - e) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
 - f) {...} – gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet magjistratëve (gjyqtarëve) sipas pikës 2, të këtij vendimi, bankës OTP Albania Sh. A dhe të bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari i Përgjithshëm, për të dërguar pranë bankës, listën e magistratëve (gjyqtarëve) përfitues.
5. Ky vendim është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.